

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË PROJEKTIN “MODERNIZIMI I ASISTENCËS SOCIALE”

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Projektin “Modernizimi i Asistencës Sociale” me objekt “” për periudhën e veprimtarisë viti 2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.121, datë 18.09.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 404/10, datë 18.09.2015, dërguar z.Blendi Klosi, Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe me shkresën nr. 404/11 datë 18/09/2015 dërguar misionit të Bankës Botërore, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

K Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar Raportet Financiare Vjetore të Programit Ndihma Ekonomike, të përgatitura nga Projekti “Modernizimi i Asistencës Sociale” në Ministrinë e Mirëqenies Sociale , Rinisë dhe Sporteve për periudhën 1 Janar 2014 – 31 Dhjetor 2014.

K Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) raporton një opinion për vërtetësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare. Ekzaminimi i Raporteve Financiare për vitin 2014, është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht për Institucionet Supreme të Auditimit ISSAI 1000-2999, të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, SNA, duke fokusuar veprimtarinë në transaksionet financiare të kryera nën Programin e Ndhmës Ekonomike si dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin lidhur me fondet e lëvruara nën këtë komponent.

Auditimi mbi “Programin Ndihma Ekonomike” siguron një bazë të arsyeshme për opinionin e auditimit si më poshtë:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

(Standardet Ndërkombëtare të Auditimit nr. 200, Opinion i pakualifikuar).

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në raportet financiare si dhe pajtueshmërinë me kornizën raportuese .

Nga auditimi u konstatua se informacionet sipas Raportit Financiar Vjetor 2014 janë korrekte dhe paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të saktë aktivitetet financiare të kryera nën Programin e Ndhmës Ekonomike **për periudhën objekt auditimi 1 janar – 31 Dhjetor 2014, përfshijnë shumën 4.709.945,82 mijë lekë. .**

Raporti Financiar i Vitit 2014 nuk përmban informacion material në kontabilitet, dhe pohimet në lidhje me këtë Program në pasqyrat financiare janë të vërteta dhe të plota.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Indeksi i pagesave për PAK të kryhet, referuar indeksimit të çmimeve për vitin përkatës, në periudhat e fillim vitit të cilit i përkasin këto indekse, si dhe udhëzimet përkatëse të dala nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për efekt të transparencës, kohës aplikimit dhe shumave përfituese, të bëhen pjesë e publikimeve në faqet zyrtare të MMSR dhe SHSSH.

Në vazhdimësi

2. Për efekte të analizave, në formulën e pikëzuar të NE të përfshihet në rubrikat e saj pyetja nëse aplikanti ka qenë përfitues i NE në periudhat e mëparshme. Gjithashtu programi i informatizuar i Ndihmës Ekonomike duhet të nxjerrë Raportin e Regjistrimit të Përfituesve të Ndihmës Ekonomike (jo vetëm listat e përfituesve) dhe në Raportin e listave të përfituesve duhet të vihen bashkëlidhur emrit të kryefamiljarit dhe emrat e bashkëshorteve të tyre.

Menjëherë

3. Nga Drejtoria e Politikave në MMSR administruesit e sistemit dhe duhet të vazhdohet të mbahet nën vëzhgim ky sistem si dhe shqyrtimi dhe trajtimi me vëmendje i të gjithë rasteve të familjeve problematike ekzistuese të pa rezultuara fituese nga sistemi, me qëllim që skema të jetë sa më efektive dhe sa më gjithëpërfshirëse e familjeve të varfra e në nevojë dhe vetëm mbas një efektiviteti maksimal të saj mund të vazhdohet me shtrirjen e skemës në të gjithë vendin. Pa këtë lloj testimi dhe arritjeje, skema do të paraqitej problematike me shtrirjen e saj në të gjithë territorin e vendit.

Në vazhdimësi

4. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Sociale në MMSR të unifikohet dhe miratohet formulari i vizitave në familje, i cili do të përdoret në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 12.12.2012“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot.”

Menjëherë

5.a-Nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Sociale në MMSR në bashkëpunim me Njësinë e Zbatimit të Projektit “Modernizimi i asistencës sociale”, të shikohet mundësia vazhdimësisë së trajnimit të administratorëve sociale për problemet e konstatuara dhe të ndryshme të rezultuara hap pas hapi. Hapësirat e kompetencave për të gjithë përdoruesit e sistemit elektronik të aplikimit të NE të saktësohen dhe në udhëzimet e nxjerra në zbatim të saj .

Në vazhdimësi

5.b- MMSR në bashkëpunim me Njësitë e reja Vendore, referuar riorganizimit dhe ndarjes së re administrative të NJQV, për efekt të eliminimit të kostove shtesë, ruajtjes së kapaciteteve njerëzore cilësore dhe profesionale, të përcaktojnë domosdoshmërinë vazhdimësisë së punës së Administratorëve Socialë të trajnuar dhe që plotësojnë kriteret e vendit të punës.

Në vazhdimësi

5.c-Referuar shkeljeve të konstatuara në Njësinë Bashkiake nr. 11, nga strukturat përkatëse të inspektimit apo auditimit të brendshëm në Shërbimin Social Shtetëror, të verifikohet ekzistenca e dëmit ekonomik të shkaktuar nga tejkalimi i kompetencave nga Administratori Social dhe Kryetari i Njësisë, në kushtet kur 8 familjet që kanë përfituar shumën prej 66,000 lekë sipas Urdhrit të Brendshëm nr. 2020 datë 6.08.2014, i nxjerrë pas Vendimit përfundimtar të DR SHSSH Tiranë për muajin Qershor (vendimi 1/1 datë 21.07.2014), janë familje që përfitojnë ose jo në bazë të akteve në fuqi.

Menjëherë

6. Nga MMSR të ndërmerret nisma ligjore e përshtatshme për kalimin dhe zyrtarizimin e kompetencave të Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore tek Shërbimi Social Shtetëror, i cili me strukturat përkatëse kryen realisht funksionet e përcaktuara në vendimin e KM nr. 512, datë 31.05.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të Ndihmës Ekonomike, të pagesës së Aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore” i ndryshuar.

Në vazhdimësi

7. MMRS, si institucioni përgjegjës për mbarëvajtjen dhe monitorimin e zbatimit të Programit, të kërkojë nga Ministria e Financave detajimin e fondeve të buxhetuara sipas

Programeve përkatëse , në mënyrë të veçantë për fondet e akorduara për Programin e Ndhmës Ekonomike dhe gjithashtu veçmas për Pagesat e Paaftësisë.

Menjëherë

8. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të nxisë dhe sugjerojë iniciativë Njësive të Qeverisjes Vendore për përfshirjen në Strategjitë e Zhvillimit dhe Planet e Veprimtarive, të masave që do të mund të sigurojnë fonde të mjaftueshme për mbështetjen me përkrahje sociale të familjeve në nevojë. Bashkëpunimi ndërmjet palëve, ndërmjet Njësive të qeverisjes Vendore, strukturave të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Shërbimit Social Shtetëror është i nevojshëm për të siguruar efektivitetin e masave.

Në vazhdimësi

9.a-Ministria Mirëqenies Sociale dhe Rinisë të synojë ndryshimet ligjore dhe hartimin e politikave që gjenerojnë zhvillimin, duke e kthyer skemën e Ndhmës Ekonomike në një skemë nxitëse dhe të lidhur ngushtë me programe të tjera të nxitjes së punësimit.

9.b-MMRS, Shërbimi Social Shtetëror dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore në zonat ku nuk ka filluar të aplikohet Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Informacionit për Programin e Ndhmës Ekonomike, të vendosin Marrëveshje Bashkëpunimi bilaterale apo multilaterale për sigurimin e informacionit të nevojshëm në rrugë zyrtare nga Institucionet përkatëse, zotëruese të informacionit. Këto marrëveshje duhet të përcaktojnë procedurat e sigurimit të informacionit si dhe rregullimin e çështjeve të tjera që shoqërojnë këto procese siç janë kostot që do të kryhen dhe cila prej palëve do t'i përballojë ato.

Në vazhdimësi

10. Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të stafit nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për administratorët lokalë dhe të vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme performancën e tyre. Kjo duhet të shtrihet dhe me forcimin e strukturave inspektuese që janë ngritur dhe funksionojnë pranë Shërbimit Social Shtetëror dhe Auditimin e Brendshëm në këtë Institucion.

Në vazhdimësi

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Albana Gjinopulli, Nikoleta Piranjani, Amantia Patozi dhe Migena Nushi, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj